



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 277 Akti**

**Nr. 510 Vendimi**  
**Tiranë, më 17.2.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Lulzim Hamitaj**  
**Genta Tafa (Bungo)**  
**Suela Zhegu**

**Relator**  
**Kryesuese**  
**Anëtare**

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar Elka Ermenkova, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Maksim Sota, Prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë.**

**OBJEKTI:** **Ndërprerja e procesit të rivlerësimit kalimtar.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni G, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**  
**Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;**  
**Germa “a”, e pikës 1, të nenit 64 dhe neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;**  
**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.**

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes z. Lulzim Hamitaj, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr.\*\*\*, datë 14.1.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për arsyet e dorëheqjes nga statusi i magjistratit nga subjekti i rivlerësimit z. Maksim Sota, i cili ka kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit z. Maksim Sota, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti i rivlerësimit z. Maksim Sota, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur, më datë 15.3.2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 20.3.2019, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, Komisioneren znj. Genta Tafa (Bungo), më tej të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:

a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;

b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;

c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

5. Gjatë hetimit administrativ, e konkretisht në datën 19.1.2022, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është depozituar dokumenti “Vendimi Nr. \*\*\*, datë 14.1.2022, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë” nga ku, me propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur “*Mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes<sup>1</sup> së z. Maksim Sota*”, vendim ky që i është njoftuar organeve kompetente si Prokurorisë së Përgjithshme, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe magjistratit Maksim Sota.

6. Kolegji i Posaçëm i Apelimit me shkresën nr. \*\*\* Prot, datë 24.1.2022, ka bërë me dije se nuk është regjistruar në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit të Rivlerësimit, ankim për subjektin e rivlerësimit z. Maksim Sota.

---

<sup>1</sup> Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 14.1.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bëhet me dije se është regjistruar pranë këtij institucioni kërkesa për dorëheqje e magjistratit Maksim Sota me nr. \*\*\* Prot, datë 13.12.2021.

7. Bazuar në njoftimin e vendimit të deklarimit të mbarimit të statusit të magjistratit për z. Maksim Sota, nga KLP-ja, por dhe nga subjekti me anë të kërkesës së tij, Komisioni pezulloi procedurën e rivlerësimit, duke i kërkuar informacion Gjykatës Administrative të Apelit me anë të shkresës Nr. \*\*\* Prot, datë 11.2.2022, e cila nëpërmjet shkresës Nr. \*\*\* Prot, datë 15.02.2022, bëri me dije se deri në datën 14.2.2022, nuk është paraqitur ankim ndaj vendimit nr. \*\*\* , datë 14.01.2022 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

8. Bazuar në faktet se: (i) KLP-ja, me vendimin nr. \*\*\* , datë 14.1.2022, ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Maksim Sota, prokuror pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për shkak të dorëheqjes nga ky status; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. \*\*\* , datë 14.1.2022 të KLP-së, Komisioni, në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, e njoftoi subjektin mbi të drejtën që gëzon për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore me anë të postës elektronike, duke i kërkuar konfirmimin e vullnetit të tij të pavesuar për dorëheqjen nga statusi i magjistratit, duke e njoftuar edhe mbi pasojat e kësaj dorëheqjeje për efekt të procesit të rivlerësimit, si dhe mbi vullnetin e tij për pjesëmarrje në seancë publike.

9. Subjekti i rivlerësimit, z. Maksim Sota, me anë të postës elektronike<sup>2</sup> konfirmoi vullnetin e tij se nuk është i interesuar dhe nuk dëshiron të dëgjohet në seancë dëgjimore publike, duke konfirmuar kështu edhe vullnetin e tij të lirë dhe të pavesuar lidhur me pasojat e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës.

## II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

1. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Trupi gjykues konstaton se z. Maksim Sota ka qenë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, referuar përkufizimit të termit “magjistrat” në ligjin nr. 96/2016, në germën “gj”, të nenit 2, në kuptim të germës “g” të këtij neni.

3. Në germën “b”, të pikës 1, të nenit 164, të ligjit nr. 96/2016 parashikohet se gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, por ky status do të mbahet vetëm nëse kalohet me sukses procesi i rivlerësimit dhe konfirmohen në detyrë.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. \*\*\* , datë 14.1.2022, ka vendosur të deklarojë “Mbarimin e statusit të magjistratit për prokurorin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, z. Maksim Sota”, për shkak të dorëheqjes së tij nga statusi i prokurorit.

5. Në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pika 1, germa “a”, përcaktohet se:

“Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur,

a) Jep dorëheqjen;

b) .....

<sup>2</sup> Referuar postës elektronike të datës 15.2.2022 si dhe përgjigjes së magjistratit të datës 16.2.2022.

6. Në nenin 65, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është parashikuar procedura që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si më poshtë vijon:

*“ 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.*

7. Neni “G”, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon :

*“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

*2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

8. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga statusi i magjistratit.

9. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, parashikojnë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke zbatuar në këtë rast nenin G të Aneksit të Kushtetutës, që parashikon ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Maksim Sota.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, më datë 17.2.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim Hamitaj**

**Genta Tafa (Bungo)**

**Suela Zhegu**

**Relator**

**Kryesuese**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore  
Ertugena Sokoli*